

**STATUT**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**"NTEPPE CONCEPT COMMERCE" SHPK**

Sot me date 22,07.2018, ne Tirane, ortaku i vetem themelues:

**Jean Nteppe** i biri i Nteppe -it, shtetas cameroun, lindur me 16.10.1997, ne yaounde Cameroun, banues ne adresen: Rruga Skender Kosturi nr 43 pallati5 kati 1 Tirane mbajtes i pasaportes me nr. A0028300, te leshuar me date 02..09.2013. madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar, njohes i gjuhës angleze dhe frengjisht

Me vullnetin e tij te lire dhe te plote, ne cilesine e ortakut te vetem te shoqerise, bazuar ne legjislacionin shqiptar:

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;

- Ligji Nr. 9901, Dt. 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare";
- Ligji Nr. 9723, Dt. 03.05.2007, "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë;

si dhe gjithashtu bazuar ne gjithe legjislacionin ne fuqi ne Republikën e Shqipërisë, harton kete statut te shoqerise tregtare "**NTEPPE CONCEPT COMMERCE**" **shpk**, e cila ka formen e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar, (sh.p.k), si nje shoqeri e te drejtes shqiptare, e cila do te funksionojë ne perputhje me ligjin shqiptar dhe ne perputhje me Statutin, sic vendoset me poshte:

**DISPOZITA TE PERGJITHSHME Neni 1 Emertimi i shoqerise** Emertimi i shoqerise eshte "**NTEPPE CONCEPT COMMERCE**" sh.p.k., me poshte e quajtur edhe "Shoqeria". Vendimin per emrin dhe emertimin e shkurtuar te shoqerise e merr Ansambleja e Shoqerise.

**Neni 2 Selia e shoqerise .**

Selia e shoqerise "**NTEPPE CONCEPT COMMERCE**"sh.p.k eshte ne adresen Rr Skender Kosturi, Nr.43, Pll.5, Kati i 1

"Tirane, Shqiperi. Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj. Shoqeria mund te hape filiale te tjera ne rrethe te tjera te vendit.

**Neni 3 Kohezgjatja e shoqerise** 1. Kohezgjatja e shoqerise "**NTEPPE CONCEPT COMMERCE**" do te jete per nje periudhe te pacaktuar, duke filluar nga momenti i regjistrimit te saj ne QKR, Tirane.

**Neni 4 Objekti i veprimtarise** Objekti i veprimtarise te shoqerise tregtare "**NTEPPE CONCEPT COMMERCE**" sh.p.k eshte:

- import - eksport mallrash te veshjeve i cili do te zhvillohet ne perputhje me ligjet dhe aktet nenligjore ne fuqi, te cilat rregullojne kete fushe.

#### **Neni 5**

Shoqëria mund të ndryshojë emërtimin, selinë, kohëzgjatjen dhe objektin e veprimtarisë së saj sipas vendimeve që do të marrë ortakët e vetëm.

#### **Neni 6**

##### **Kapitali i shoqërisë**

6.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 leke (një qind) leke dhe është përbërë nga 1 kuote

Kapitali i mesiperm është nënshkruar dhe shlyer tërësisht në të holla nga ortakët e shoqërisë përkatësisht :zotuesi i 1 kuote, me vlerë të përgjithshme 100 leke , që përbejnë 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kapitali themeltar mund të ndryshohet vetëm me vendim të ortakëve të vetëm

Pjesët e kapitalit themeltar janë të transferueshme në çdo formë që parashikon ligji

#### **Neni 7**

##### **Drejtimi dhe administrimi**

7.1 Shoqëria tregtare "NTEPPE CONCEPT COMMERCE" sh.p.k është pronë e ortakëve të vetëm ,Jean Nteppe i cili gëzon të gjitha atributet e Asamblesës së Shoqërisë

7.2 Administrimi i shoqërisë kryhet nga Administratori, duke respektuar aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

7.3 Administrator i shoqërisë është ,Jean Nteppe shtetas Cameroun, i datëlindjes 16.10.1997, banues në Tirane, me adresë: Rruga Skender Kosturi nr.43 Ap 43 kati 1 , mbajtes i pasaportës cameroun vetjake, me numër 0028300, të leshuar në datë 02.09.2013

7.4 Administratori ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë dhe të drejtojë punën e përditshme të shoqërisë në përputhje me ligjet dhe aktet ligjore në fuqi. Në mungesë të tij shoqëria administrohet nga përfaqësuesi ligjor me prokurë të noterizuar vetëm sipas tagreve të caktuar në prokurë.

#### **Neni 8**

##### **Marrëdhëniet e punës**

Marrëdhëniet e punës në shoqëri rregullohen nëpërmjet kontratave të punës.

#### **Neni 9**

##### **Kontrolli i brendshëm**

Shoqëria tregtare "NTEPPE CONCEPT COMMERCE" sh.p.k organizon kontrollin e brendshëm kontabël me ekspertë kontabël të autorizuar, i cili caktohet nga ortakët e vetëm.

#### **Neni 10**

##### **Dispozita financiare**

10.1 Viti financiar fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Viti i parë nis nga data në të cilën Shoqëria është njohur ligjrisht, deri me 31 dhjetor të po atij viti.

10.2 Me mbylljen e vitit financiar, administratori merr masë për hartimin e bilancit të vitit financiar të mbyllur

10.3 Për sa i përket kontabilitetit zbatohen rregullat e përcaktuara nga ligji shqiptar në fuqi.

**Neni 11**  
**Trashëgimia**

Pasuria e shoqërisë është lirisht e trashëgueshme në rrugë trashëgimie.

**Neni 12**  
**Prishja dhe likuidimi i shoqërisë**

Në rastin e prishjes dhe likuidimit të shoqërisë do të zbatohen dispozitat e nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"

**Neni 13**  
**Ligji i aplikueshëm**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe këtë statut.

Ky Statut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është hartuar në 5 (pesë) kopje në gjuhën shqipe me fuqi të njëjtte ligjore dhe janë nënshkruar rregullisht nga ortaku i vetëm themelues.

**Neni 14**  
**Dispozita të tjera**

14.1. Per te gjitha çeshtjet qe nuk gjejne rregullim ne kete Statut, aplikohen dispozitat e ligjit nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe aktet e tjera ligjore/nënligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

14.2. Mosmarreveshjet eventuale gjate ekzistences se shoqërisë ose gjate periudhes se likuidimit, ndermjet ortakeve, ndermjet shoqërisë dhe ortakeve apo ndermjet shoqërisë dhe te treteve, do te zgjidhen sipas legjislacionit Shqiptar dhe gjykate kompetente do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

**ORTAKU THEMELUES**

Jean Nteppe

